



Në bazë të nenit 22 dhe nenit 23 paragrafit 1 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesit ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 12/2019), Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (në tekstin e mëtejme: DKSK) më 83- seanca e mbajtur më 27.02.2023 miratoi,

Vendim

Procedura e kontrollit të të dhënave për gjendjen pronësore nga fleta anketuese i -----, kryetarit të Gjykatës Themelore ---, NDËRPRITET.

Në përputhje me dispozitat e Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave nuk ka elemente për veprim të metutjeshëm të KSHPK-së sipas lëndës me numër 08-1308/1 të datës 22.02.2020.

Lënda me numër 08-1308/1 të datës 13.02.2020 të mbyllet dhe të arkivohet.

Vendimi i KSHPK-së, me arsyetimin në formë të depersonalizuar të publikohet në veb faqen e KSHPK-së në afat kohor prej 5 (pes) ditëve nga dita e miratimit.

Arsyetim

Lënda me numër 08-1308/1 datë 22.02.2020 është formuar me iniciativë të saj, bazuar në Planin Vjetor për monitorimin e gjendjes pronësore dhe interesave për vitin 2020.

KSHPK, ka kërkuar nga personi i përmendur informacione për anëtarët e familjes së tij me të cilët jeton në një familje të përbashkët.

Të dhënat e kërkuara janë dhënë nga personi i përmendur.

Për konstatimin e gjendjes faktike në rastin konkret, KSHPK-ja ka marrë të dhëna për pronën e ----- dhe familjarëve të tij nga Agjencia e Kadastrës së Patundshmërive, Ministria për punë të brendshme, Drejtoria e të hyrave publike, Depozita qendrore e letrave me vlerë dhe Regjistri qendror i Republikës së Maqedonisë së Veriut.

KSHPK-ja gjithashtu kërkoj informacion nga Këshilli Gjyqësor se kur ----- u zgjodh kryetar i Gjykatës Themelore ----- . Këshilli Gjyqësor ka dërguar njoftim se personi i emëruar është zgjedhur më datë 03.10.2019.

KSHPK-ja konstatoi se i emëruari nuk ka dorëzuar flet anketuese për zgjedhjen e kryetarit në Gjykatën Themelore -----.

Në bazë të nenit 114 paragrafi (3) të Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit, KSHPK-ja lëshoi dhe i dorëzoi personit të përmendur një urdhërpagesë kundërvajtëse me një shumë të caktuar të gjobës. Nga personi i përmendur për urdhërpagesën e lëshuar së lëshuar për kundërvajtje, pas së cilës KSHPK-ja ka lëshuar kërkesë për iniciimin e procedurës për kundërvajtje në Komisionin për Kundërvajtje pranë KSHPK-së. Komisioni për kundërvajtje ka marrë VENDIM se personi i përmendur është PËRGJEGJËS dhe është shqiptuar gjobë prej 18.447,00 denarë.



Nga sa mē sipēr, Komisioni Shtetēror pēr Parandalimin e Korrupsionit vendosi si nē dispozitiv tē kētij vendimi.

KOMISIONI SHTETĒRORĒ
PĒR PARANDALIMIN E KORRUPTIONIT
Nēnkryetar
Katica Nikolovska
